

MJAFT!
www.mjajt.org


QEVERISJA E HAPUR E NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

PROPOZIME PËR PËRMISIMIN E SITUATËS



Norwegian Embassy

PARTNERËT SHQIPËRI
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM



QEVERISJA E HAPUR E NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË PROPOZIME PËR PËRMIRËSIMIN E SITUATËS

Ky grant është mundësuar nga 'Programi i shoqërisë civile për Shqipërinë dhe Kosovën', financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) në partneritet me Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim (PA). Përmbajtja dhe rekomandimet e paraqitura nuk përfaqësojnë qëndrimin zyrtar të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë dhe Partnerëve Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim (PA).

Gusht 2022

AUTORË


Aldo MERKOÇI – Drejtor Ekzekutiv, Lëvizja MJAFT!
Xheni LAME – Menaxhere Programi, Lëvizja MJAFT!





Tabela e përmbajtjes:

1	Hyrje	4
2	Hapja institucionale e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore në Shqipëri	6
2.1	Njësitë e vetëqeverisjes vendore në Shqipëri	7
3	Metodologjia e kërkimit	10
4	Rekomandime për hapa konkretë veprimi	11




Bazuar në metodologjinë për matjen e hapjes institucionale, Lëvizja MJAF! ka përgatitur këtë punim mbi politikat, në të cilin janë analizuar nivelet e transparencës dhe llogaridhënies së njësive të vetëqeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë. Punimi paraqet rezultate të një kërkimi gjithëpërfshirës, bazuar në metodologji shkencore, e krijuar nga anëtarë të rrjetit të ActionSEE¹. Qëllimi i këtij kërkimi është të prezantojë një këndvështrim të përgjithshëm të gjendjes aktuale të njësive të vetëqeverisjes vendore, si dhe të kontribuojë në zbatimin e reformave të ndërmarra për administratën publike, të ndikojë në përforcimin e parimeve të mirëqeverisjes dhe të ndihmojë institucionet në zbatimin më eficient të detyrave të tyre operative. Ky dokument përmban rezultatet e hulumtimit të realizuar përgjatë periudhës mars – gusht 2022, si dhe rekomandime për përmirësimin e hapjes institucionale të njësive të vetëqeverisjes vendore. Duke marrë në konsideratë punën e bërë ndër vite, në partneritet me organizatat e rajonit, disa prej treguesve që masin performancën janë rishikuar dhe ndryshuar në varësi të rezultateve të matura, të cilat prezantonin gjendjen e institucioneve të Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë edhe mangësitë që institucionet shfaqin, dhe praktikat e mira në këtë fushë.

Në këtë studim, metodologjia matjes së performancës së institucioneve publike është përmirësuar dhe modifikuar; treguesit e saj janë përshtatur mbi bazën e rezultateve dhe gjetjeve të monitorimit, zhvilluar vitet e shkuara, duke synuar gjenerimin e informacionit që dotë kontribuojnë rezultate më të mira të projektit. Qëllimi i përdorimit të treguesve të rinj dhe të përmirësuar është shtimi i një dimensionit të ri në këtë kërkim

FAKTI

dhe një qasje më efiçente ndaj përmirësimit të hapjes institucionale në vend. Duke zotëruar njohuri, rezultate konkrete dhe analiza të qeverisjes së hapur institucionale, si dhe duke besuar në përmirësimin e punës së njësive të vetëqeverisjes vendore në këtë fushë, të ndikuar edhe nga hapa konkretë të prezantuar në udhëzuesit e përgatitur, synojmë të advokojmë për një nivel më të lartë të qeverisë së hapur në Shqipëri. Për këtë arsye, kërkimit të këtij viti i janë shtuar tregues, të cilët advokojnë për standarde më të larta të transparencës proaktive.

Politika e qeverisjes së hapur duhet të jetë një politikë e zbatuar në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe duhet të përkufizohet ashtu si politikat e tjera të rëndësishme, dhe jo të vijë si rezultat i një vendimi aktual apo i gjendjes së forcës aktuale në pushtet. Propozimi ynë i adresohet vendimmarrësve të njësive të vetëqeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë. Ky punim mund të jetë i dobishëm për përfaqësuesit e institucioneve ndërkombëtare dhe për kolegët e organizatave të shoqërisë civile, të cilët punojnë mbi çështje të tilla. Në mënyrë që të arrihet një dialog publik i cilësive të larta lidhur me këto çështje, si dhe për të siguruar arritjen e parimeve të transparencës së kërkimit, institucionet publike do të informohen mbi të gjitha detajet e kryerjes së tij dhe konkluzionet e përshtatura. Databaza me të dhënat e hapura të mbledhura në kuadër të këtij programi do të jetë e aksesueshme për të gjithë të interesuarit². Jemi në dispozicionin tuaj për të gjitha sugjerimet, kritikën konstruktive dhe diskutimet lidhur me këtë punim!



.....

¹ ActionSEE "Accountability, Technology and Institutional Openness in South Eastern Europe" (<https://actionsee.org/>) është rrjet rajonal organizatash nga vendet e Ballkanit Perëndimor, që kanë ndërtuar Indeksin Rajonal të Hapjes. Për të gjeneruar Indeksin Kombëtar të Hapjes për Shqipërinë është ndjekur e njëjta metodologji, sikurs Lëvizja MJAFT! është pjesë e këtij rrjeti, që prej vitit 2016.

² ActionALBANIA "Accountability, Technology and Institutional Openness in Albania": <https://actionalbania.org/en>

HAPJA INSTITUCIONALE E NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE NË SHQIPËRI

Përpjekje të koordinuara ndër-institucionale janë ndërmarrë që prej Reformës Administrativo-Territoriale³ të vitit 2014, për të përmirësuar performancën e njësive të vetëqeverisjes vendore, rritjes dhe forcimit të kapaciteteve të personave të këtyre njësive, si dhe rritjes së transparencës. Prej fundit të vitit 2021, diskutime mbi rishikimin dhe ndryshimin e kësaj reforme kanë filluar ndërmjet qeverisë dhe partisë më të madhe në opozitë. Në kuadër të këtyre diskutimeve, është krijuar gjithashtu Komisioni i Posaçëm Parlamentar "Për reformën Administrativo-Territoriale në Republikën e Shqipërisë. Qëllimi i këtij komisioni është të vlerësojë rezultatet e arritura nga reforma e 2014-s dhe të bëjë modifikime sipas nevojës së lindur, me në qendër qytetarin dhe përmirësimin e shërbimeve të ofruara ndaj tyre. Duke synuar qytetarin në qendër gjithashtu, opozita propozon ndryshime edhe më thelbësore, siç është ndryshimi i numrit të njësive të vetëqeverisjes vendore nga 61 në 95 bashki, nxitur me pretendimin se ndarjes aktuale është e ndikuar nga interesat politike jo në dobi të komuniteteve⁴. Komisioni i posaçëm

i krijuar në qershor të këtij viti, ende nuk ka arritur në një propozim final të konkluduar ndërmjet palëve të përfshira politike.

Kontribut shumë të rëndësishëm për mbështetjen e Reformës Administrativo-Territoriale ka dhënë projekti "Star 2". Një projekt me vlerë 8.2 milionë EUR, i financuar 43% nga Bashkimi Europian dhe mbështetur nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara, Qeveria e Suedisë, Qeveria e Italisë, Qeveria Zvicerane, Shtetet e Bashkuara, Qeveria Shqiptare, projekt i cili synoi arritjen e objektivave për periudhën korrik 2016 – dhjetor 2019⁵. Projekti u hartua me qëllim: (i) forcimin e kapaciteteve institucionale dhe administrative, (ii) përmirësimin e efikasitetit të ofrimit të shërbimeve, dhe (iii) rritjen e demokracisë vendore përmes nxitjes së qeverisjes me në qendër qytetarin dhe vendimmarrjen me pjesëmarrje, duke shfrytëzuar rolin e grave si aktorë ndryshimi⁶.

Gjithashtu, Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale është fokusuar në vitet e fundit në trajnimin dhe rritjen e kapaciteteve të stafit administrativ të këtyre njësive, me qëllim ndërgjegjësimin e tyre në dhënie të informacionit publik proaktiv, për të qenë sa më transparente ndaj qytetarëve të komunitetit që mbulojnë. Pavarësisht se udhëri nr.187, datë 18/12/2020 "Për miratimin e programit të transparencës së rishikuar"⁷ ngarkon për zbatim të gjitha autoritetet publike, me përjashtim të njësive të vetëqeverisjes vendore, nga monitorimi është vënë re se thuajse çdo njësi që ka një faqe zyrtare, ka përshtatur këtë model programi transparence për të publikuar informacionin e parashikuar në nenin 7 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", për kategoritë e informacionit që duhet të bëhet publik pa kërkesë. Përgjatë vitit 2021, zyra e komisionerit ka realizuar dy monitorime për transparencën e njësive të vetëqeverisjes vendore, referuar përditësimin të programeve të transparencës, rregjistrin të kërkesave dhe përgjigjeve, të dhënat e koordinatorit për të drejtën e informimit dhe koordinatorit për konsultimin

publik, si dhe të dhënat për buxhetin dhe planin e shpenzimeve financiare. Sipas këtyre monitorimeve, pushteti vendor ka një rritje të performancës së transparencës krahasimisht me vitin 2020⁸. Këto përpjekje kanë ndikuar në rritjen e transparencës institucionale ndër vite; krijimi i faqeve zyrtare të internetit, hartimi i modeleve të

programeve të transparencës, zhvillimi i trajnimeve relevante për fushën (edhe pse të pakta në numër), kanë ndikuar në nxitjen e dhënies proaktive të informacionit, edhe pse këto institucione mbeten ende shumë të ngurta në zbatimin e vullnetit politik për të qenë sa më të hapura ndaj qytetarëve.

2.1

NJËSITË E VETËQEVERISJES VENDORE NË SHQIPËRI

Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore të Republikës së Shqipërisë, në matjet e bëra për të dhënat e publikuara të veprimtarisë institucionale të vitit 2021, kanë shënuar 36.04% në përmbushjen e treguesve të hapjes institucionale. Në krahasim me rezultatet e vitit 2018, pushteti vendor ka shënuar lehtësisht pozitivisht në plotësimin e treguesve të hapjes institucionale, ku rezultati total i pushtetit ishte në nivelin e 35.7%. Megjithatë, rezultati mbetet ende shumë i ulët, pavarësisht diferencës me 0.34 pikë përqindjeje ndërmjet dy matjeve të fundit. Duke konsideruar periudhat e matjeve, në tre vitet e fundit, pavarësisht punës dhe presionit të vazhdueshëm për këtë pushtet për të qenë më transparent, reagimi mbetet në nivele shumë të ulët dhe jo të kënaqshme.

Me specifikisht, shtyllat kryesore nga të cilat gjenerohet Indeksi Kombëtar i Hapjes

Institucionale, për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë rezultojnë 24.56% plotësim të treguesve të transparencës, 28.21% të aksesueshmërisë, 58.03% të integritetit dhe 68.78% të efektshmërisë dhe ndërgjegjësimit institucional. Performanca e këtyre shtyllave në vitin 2018 ishte si në vijim: aksesueshmëria, 33.58% të plotësimit të indikatorëve, integriteti 45.1%, transparenca 27.03% dhe efektshmëria 71.76%. Për sa i takon publikimit të dokumentave në formatin e të dhënave të hapura, në vitin 2018 performanca ka qenë 13.12%⁹, ndërsa në këto matje ka rezultuar 15.18%.

³ Ligji nr. 115/2014 "Për ndarjen Administrativo-Territoriale të Njërive të Vetëqeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë, link: https://aam.org.al/wp-content/uploads/2018/11/Ligj_115-2014_31.07.2014.pdf

⁴ Porta Vendore, mars 2022: <https://bit.ly/3G1xXuj>, si dhe Porta Vendore, tetor 2022: <https://bit.ly/3YCSek1K>

⁵ EU projects in Albania, link: <https://bit.ly/3Wf6vzW>

⁶ Porta Vendore, link: <https://bit.ly/3FKrFia>

⁷ Urdhër nr.187, link: <https://bit.ly/3Wdw04vc>

⁸ Raporti Vjetor, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, viti 2021, link: <https://bit.ly/3YCZ5Z2>

⁹ Raporti i Hapjes Institucionale të Njërive të Vetëqeverisjes Vendore, viti 2019: <https://bit.ly/3PGjs3i>

Renditja e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, sipas performancës së rezultuar në matjen e këtij viti, është si në vijim:

1.	Skrapar 56.21%	32.	Pukë 35.67%
2.	Patos 56.09%	33.	Tepelenë 35.55%
3.	Malësi e Madhe 53.39%	34.	Kamëz 34.73%
4.	Sarandë 53.04%	35.	Korçë 34.26%
5.	Klos 52.33%	36.	Kurbin 34.26%
6.	Mat 50.92%	37.	Memaliaj 34.14%
7.	Shkodër 50.92%	38.	Këlcyrë 33.21%
8.	Tiranë 50.34%	39.	Poliçan 33.09%
9.	Finiq 49.63%	40.	Cërrik 31.91%
10.	Maliq 49.63%	41.	Himare 30.5%
11.	Lezhë 48.45%	42.	Delvinë 30.27%
12.	Kuçovë 47.87%	43.	Gramsh 30.15%
13.	Përmet 47.4%	44.	Vorë 29.08%
14.	Pogradec 46.35%	45.	Devoll 28.62%
15.	Kolonjë 46%	46.	Vau i Dejës 27.22%
16.	Prrenjas 45.53%	47.	Durrës 26.63%
17.	Berat 44.24%	48.	Bulqizë 26.51%
18.	Roskovec 43.77%	49.	Pustec 25.06%
19.	Shijak 42.94%	50.	Vlorë 23.94%
20.	Has 42.47%	51.	Divjakë 23.23%
21.	Peqin 42.24%	52.	Kavajë 20.41%
22.	Dibër 42.12 %	53.	Rrogozhinë 16.67%
23.	Dimal 41.42%	54.	Selenicë 13.13%
24.	Gjirokastër 41.18%	55.	Belsh 12.43%
25.	Dropull 40.6%	56.	Fier 10.08%
26.	Libohovë 40.37%	57.	Librazhd 7.98%
27.	Mirditë 40.1%	58.	Fushë-Arrëz 6.81%
28.	Elbasan 39.66%	59.	Konispol 6.81%
29.	Kukës 39.19%	60.	Krujë 6.81%
30.	Mallakastër 38.72%	61.	Lushnje 6.81
31.	Tropojë 37.66%		

TRANSPARENCA

Nga monitorimi është vënë re se pesë njësi të vetëqeverisjes vendore nuk kanë faqe zyrtare, përkatësisht Bashkia Fushë-Arrëz, Fier, Krujë, Konispol dhe Lushnje, gjë e cila shpjegon performancën e ulët të këtyre institucioneve në arritjen e standardeve ndërkombëtare të hapjes institucionale. Ndërsa faqet zyrtare të bashkive Elbasan dhe Roskovec rezultuan jo të sigurt në momentet e kërkimit të informacionit në brendësi të tyre.

Pavarësisht kuadrit ligjor, të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore që kanë një faqe zyrtare, kanë përshtatur modelin e udhëzuar nga Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit për Programet e Transparencës. Megjithatë, pavarësisht kësaj përshtatjeje, vihet re se ende mungon informacioni relevant i publikuar sipas udhëzimeve të përcaktuara. Dokumentat që mungojnë në frekuencë më të shpeshtë lidhen me planet dhe raportet vjetore, si dhe raportet periodike. Gjithashtu, informacioni mbi organigramën e institucionit dhe të dhënat e kontaktit të personelit.

Transmetimi audio-viziv i mbledhjeve të këshillit bashkiak mbetet një çështje e paadresuar nga pushteti lokal. Në tërësi, informacioni që raporton punën e këshillave bashkiak në Shqipëri është i munguar; veprimtaria e këtyre institucioneve konsiderohet ende e mbyllur dhe ka mungesë ndërgjegjësimit për t'i bërë mbledhjet të hapura për qytetarët.

Dokumentacioni për buxhetin dhe prokurimet publike mbetet i papublikuar edhe në rastin e pushtetit vendor. Planet dhe realizimet gjenden përgjithësisht të publikuara, por dokumentat në lidhje me procedurat e thirrjeve, vendimeve dhe kontratave mbeten ende të paplotësuara në gjenerimin e indeksit.

Pavarësisht se Reforma Administrativo-Territoriale ka në qendër të saj përfshirjen e qytetarit në proces, realizimi i procedurave të njoftimit dhe konsultimit publik në nivel lokal shënon ende negativisht. Informacioni mbetet i limit dhe shpesh-herë, ajo që publikohet lidhet me figurën e drejtuesve politikë, dhe jo përmbajtjes së procesit.

AKSESUESHMËRIA

Gjatë monitorimit është vënë re mungesë informacioni për trajnimet e personelit të administratave të pushtetit lokal. Këto trajnime konsiderohen të rëndësishme në rritjen e aksesueshmërisë, pasi përmes këtyre trajnimeve personeli forcon kapacitetet në përafrimin e kontributit të komuniteteve në procese vendimmarrëse. Edhe në rastet kur institucionet pretendojnë përfshirjen e qytetarëve në procese, siç është buxheti me pjesëmarrje, informacioni i publikuar është shumë i kufizuar, duke mos lënë mundësi për të vlerësuar ndikimin e këtyre takimeve në kontribut konkret.

Edhe pse pushteti lokal hap thirrje për grante për organizata të shoqërisë civile, jo të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë mbështetur nisma të tilla. Por edhe në rastet kur pushteti lokal ka financuar nisma të organizatave, jo të gjitha fazat e grantimit janë bërë publike me publikun e gjerë.

Një gjetje tjetër gjatë monitorimit ka qenë publikimi i email-eve jo zyrtare të Koordinatorëve të caktuar për të Drejtën e Informimit. Konkretisht, praktikë e tillë gjendet në faqet e 23 njësive: Belsh, Devoll, Cërrik, Dibër, Divjakë, Dropull, Fushë Arrëz, Gramsh, Himarë, Korçë, Kurbin, Lushnje, Maliq, Mat, Memaliaj, Përmet, Poliçan, Pukë, Pustec, Selenicë, Shijak, Dimal, Vorë. Edhe pse çdo institucion ka për detyrë të dërgojë listën e punonjësve tek Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për të krijuar adresa zyrtare komunikimi, shihet që disa njësi lejojnë përdorimin e email-eve personale.

INTEGRITETI

Dokumentat që mungojnë më së shumti në plotësimin e komponentit të integritetit për njësitë e vetëqeverisjes vendore pengojnë krijimin e urave të komunikimit online ndërmjet publikut apo palëve të interesuara me institucionin, për të shprehur ankesat apo shqetësimet e tyre. Planet e integritetit dhe treguesit e matjes së integritetit mungojnë, gjithashtu.

Treguesit e performancës për të planifikuar dhe matur punën vjetore të institucionit janë dy elementë të cilët ulin performancën e komponentit të efektshmërisë për njësitë e vetëqeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë. Strategjitë e zhvillimit për këto njësi gjenden vetëm në disa prej tyre të publikuara. Në thuajse të gjitha rastet, sesioni i pyetjeve të drejtuara ndaj njërive dhe përgjigjet e dhënë prej tyre, është i munguar; nuk gjendet asnjë dokument përmbledhës për pyetje/përgjigjet më të shpeshta, gjë e cila ul ndjeshëm proaktivitetin me qytetarët e territorit që këto njësi mbulojnë. Gjithashtu, jo të gjitha bashkitë që i janë përgjigjur pyetjeve të dërguara për informacion publik, kanë zbatuar afatet ligjore të ligjit për të drejtën e informimit.

3

METODOLOGJIA E KËRKIMIT

Qeverisja e hapur përfaqëson një kusht kyç të demokracisë pasi kjo u lejon qytetarëve të marrin informacion dhe njohuri të nevojshme për pjesëmarrje të barabartë në jetën politike, vendimmarrje efektive dhe pasjen e institucioneve të përgjegjshme për politikën të cilat ato ndjekin. Ndërkombëtarisht, institucionet ndërmarrin aktivitete të ndryshme me qëllim rritjen e transparencës së tyre dhe llogaridhënien të qytetarët. Indeksi Kombëtar i Hapjes Institucionale të njërive të vetëqeverisjes vendore është ndërtuar në qëllim të përcaktimit se në cilën shkallë qytetarët marrin dhe kuptojnë informacionin e institucioneve të tyre. Indeksi Kombëtar i Hapjes Institucionale mat shkallën në të cilën institucionet publike janë të hapura për qytetarët dhe shoqërinë, duke u bazuar në katër parimet bazë, të cilat janë:

- 1) Transparenca
- 2) Aksesueshmëria
- 3) Integriteti
- 4) Efektshmëria

Parimi i transparencës përfshin informacionin organizativ, buxhetin dhe procedurat e prokurimeve publike, të cilat janë në dispozicion të publikut dhe të publikuara.

Aksesueshmëria është e lidhur me sigurimin dhe respektimin e procedurave për akses të lirë në informacion, duke përmirësuar disponueshmërinë e informacionit përmes mekanizmave të debatit publik dhe forcimin e ndërveprimit me qytetarët. Integriteti përbëhet nga mekanizmi i parandalimit të korrupsionit, mbajtjen e kodit etik dhe rregulloret e lobimit. Parimi i fundit, Efektshmëria i referohet monitorimit dhe vlerësimit të politikave të zbatuara nga institucionet.

Duke ndjekur standardet ndërkombëtare, rekomandimet, si dhe shembujt e praktikave të mira, këto parime janë zhvilluar më tej përmes treguesve specifikë cilësorë dhe sasiorë, të cilët janë vlerësuar në bazat e: aksesueshmërisë së informacionit në website-t zyrtare të institucioneve, shqyrtimin e kuadrit ligjor për çështje të veçanta, burimeve të tjera të informacionit publik dhe pyetësorëve të dorëzuar në institucione.

Përmes rreth 4'941 treguesve, kemi matur dhe analizuar hapjen institucionale të 61 njërive të vetëqeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë. Matjet janë kryer gjatë periudhës Mars – Gusht 2022.

REKOMANDIME PËR HAPA KONKRETË VEPRIMI

4



Referuar në standardet ndërkombëtare të mirëqeverisjes dhe hapjes institucionale, njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet të rrisë përpjekjet për të përmirësuar nivelet e transparencës institucionale dhe aksesueshmërisë së proceseve vendimmarrëse nga qytetarët e komuniteteve që ata administrojnë. Njësitë e vetëqeverisjes vendore janë strukturat që gjenden më pranë qytetarit, krahasimisht me institucionet apo autoritetet e tjera publike. Përfshirja e qytetarëve në proceset demokratike të njësive rrit besueshmërinë e tyre ndaj institucioneve dhe efektivitetin e ofrimit të shërbimeve, të orientuara sipas nevojave të komunitetit.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet të konsiderojnë me rëndësi rritjen dhe forcimin e kapaciteteve dhe ndërgjegjësimin të Koordinatorëve për të Drejtën e Informimit. Ruajtja e kujtesës institucionale, duke u angazhuar në mosndryshimin e këtij pozicioni për periudha afatmesme, do të rrisë proaktivitetin e transparencës institucionale në nivele të ndjeshme. Pjesëmarrja e personave përgjegjës në trajnime relevante për të drejtën e informimit, publikimit të të dhënave të hapura, si dhe ruajtjes së informacionit të ndjeshëm janë kyçe për sigurimin e një procesi ndërveprues dhe efektiv me komunitetet e këtyre njësive. Publikimi i informacionit të rëndësishëm për qytetarët është një nga çështjet më


prioritare për t'u konsideruar nga njësitë e vetëqeverisjes vendore. Këto të fundit duhet të orientohen drejt përqasjes me në fokus qytetarin dhe jo promovimin e figurave politike që drejtojnë institucionet.

Rritje të numrit të materialeve edukuese për qytetarët është një nga rekomandimet më të rëndësishme për t'u konsideruar nga njësitë e vetëqeverisjes vendore. Më konkretisht, pushteti lokal duhet të angazhohet në publikimin e buxhetit për qytetarët, informimin e tyre për nismat e planifikuara për diskutim nga Këshilli Bashkiak, si dhe publikimi i realizimit buxhetor vjetor përmes grafikave informuese.


Hapja dhe transparenca e diskutimeve të Këshillit Bashkiak. Pushteti lokal, përmes hapjes së diskutimeve dhe vendimeve të parlamenteve vendore, rrit besueshmërinë e qytetarit ndaj institucioneve dhe ndërgjegjësimin e tyre për të qenë pjesë e proceseve, duke kontribuar në përmirësimin e shërbimeve që ky pushtet ofron.



MJAFT!
www.mjaft.org



Norwegian Embassy



www.actionalbania.org